



DEKLARATË MBI FUQIZIMIN E FORUMIT

Ne, përfaqësuesit e Shoqatave Anëtare të Forumit Kosovar për Personën me Aftësi të Kufizuar

Pajtohem i unanimisht për rezolutën e mëposhtme:

RIA FIRMOJMË nevojën për:

- Unitetin e lëvizjes së aftësisë së kufizuar në Kosovë.
- Shoqatat anëtare të përmirësojnë kordinimin e punës së tyre në një mënyrë që do tu mundësojë atyre të jenë më përfaqësuese dhe më efektive në promovimin e të drejtave njerëzore dhe sociale të personave me aftësi të kufizuar dhe krijimin e mundësive të barabarta.
- Forumi Kosovar për Personën me Aftësi të Kufizuar të promovohet dhe të njihet si Partner Social i institucioneve, dhe se i tillë, të marrë pjesë në të gjitha organet e vendimarrjes dhe në proceset ku vendimet i prekin jetën e personave me aftësi të kufizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë.

ME KËTË RAST DEKLAROJMË TË:

- Rivitalizojmë dhe fuqizojmë pjesëmarrjen dhe kontributin tonë në Forumin Kosovar për Personën me Aftësi të Kufizuar, duke e luajtur një rol aktiv në përbushjen dhe zhvillimin e politikave kombëtare, me qëllim të avancimit të të drejtave njerëzore dhe sociale të personave me aftësi të kufizuar si edhe krijimin e mundësive të barabarta.
- Të punojmë individualisht në Shoqatat tona respektive, poashtu kolektivisht, si anëtare të FKAK-së, në mënyrë që ta bëjmë Këshillin tonë Nacional funksional dhe efektiv, të promovojmë dhe fuqizojmë unitetin e vprimeve tona, me qëllim që të arrim përfaqësimin më të mirë të mundshëm, ashtu sic përshkruhet në definimin e Këshillit Nacional të cekur në Statutin e EDF.
- Të ndërmarrim hapa konkret që të sigurohemi që Forumi Kosovar për Personën me Aftësi të Kufizuar dhe organizatat anëtare të saj, do të krijojnë kushte të përshtatësime që të përfshinë në mënyrë të përherëshme zërin e personave me aftësi të kufizuar si një komponent i qëndrueshëm i punës tonë.
- Të bashkëpunojmë për një shpërndarje më efektive të informacioneve, të shkëmbujmë përvojat në mes të shoqatave anëtare dhe të kërkoi mënyra të përmirësojmë komunikimin dhe konsultimin në baza të rregullta, dhe gjithashtu të mbështesim nismat e shoqatave tona anëtare.
- Të bashkëpunojmë me Këshillët Nacionale në shtetet fqinjë, shtetet e tjera të EU dhe OJQ-të Evropiane në projekte ndërkombëtare dhe nisma politike me qëllim të zbatimit të qëllimeve të Forumit Evropian për Personën me Aftësi të Kufizuar (EDF).

Nënshkrimet e Shoqatave Anëtare të Forumit,

Down Syndrome Kosova

Handicap Kosovo

HandiKos

Klubi "Dëshira"

OFAKOS

Shoqata Autizmi

Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

Shoqata e të Verbërve të Kosovës

BEKIM KRASNIQI